

VENDIM
Nr. 11, datë 31.3.2015

PËR LICENCIMIN SHA “UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR”

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit operatorit sh.a “Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë” me:

Drejtues ligjor: Dashmir Qeli;

Drejtues teknik : Arqile Puleri.

2. Operatori sh.a.“Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastrë” autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Gjirokastrë, komuna Lunxhëri.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare deri më datë 31.3.2017.

KRYETARI
Avni Dervishi